

VENDIM
Nr. 346, datë 4.5.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“TREGU INDUSTRIAL USHQIMOR-MARKATA”, BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Tregu industrial ushqimor-markata”, Berat.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Berat.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme 2 711 518 (dy milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 711 518 (dy milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronë-simeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 5. Shpronësimi të fillojë në datën 11.5.2016.
 6. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Berat.
 7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Berat, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
 9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA PËRMBLEDHËSE E SHPRONËSIMEVE PËR OBJEKTIN “TREGU INDUSTRIAL USHQIMOR-MARKATA”, BERAT

Nr.	Gjeneralitetet e pronarit	Ferdi Hajdar Dura	Hajrulla Shyqyri Dura	Beniamin Shyqyri Dura	Nuredin Fejzi Seitaj	Ylli Shaban Reka
1	Zona kadastrale respektive	8502	8502	8502	8502	8502
2	Nr. i pronës	8/139N1	8/139N2	8/139N3	8/139N4	8/155
3	Sipërfaqja e truallit në pronësi	5	5	12	10	
4	Sipërfaqe ndërtimore të objektit që do të shpronësohet (faktike)	8.8	11.3	15.4	11.1	90
5	Sipërfaqe ndërtimore të objektit që do të shpronësohet (sipas dokumenteve të pronësisë)	5	5	12	10	90
6	Çmimin për njësi të truallit sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016	4183	4183	4183	4183	
7	Vlerën e truallit në total që do të shpronësohet	20915	20915	50196	41830	
8	Vlera e përlogaritur e ndërtesës sipas faktit (vlera e preventivuar)	236,471	251,973	263,581	298,189	1,857,786
9	Vlera e përlogaritur (interpoluar) e ndërtesës sipas sipërfaqeve të dokumenteve të pronësisë	134,358	111,492	205,387	268,639	1,857,786
10	Vlera totale për shpronësim (truall+ ndërtesë, sipas dokumenteve të pronësisë)	155,273	132,407	255,583	310,469	1,857,786
	SHUMA, GJITHSEJ				Lekë	2,711,518